

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. BERNINA KONDI

06/15/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 5.6.2020 për subjektin e rivlerësimit, Bernina Kondi, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 15.6.2020, vendosi: Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Xhensila Pine, znj. Brunilda Bekteshi relatores, z. Olsi Komici anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe / ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.